

PRS.0142

## RINGSEAL T21

Guarnicion prej gome hidroekspansive për diferencues të kasetave të tubave

### Kodi doganor

4016 9300

### Amballazhimi

- Thes 100 copë

### Aplikimi

- Aplikim manual

Familja  
Proseal

Tipologjia  
Produkte prej gome hidroekspansive

Linjat e produkteve  
• Aqua  
• Building  
• Infratech

Kategoritë e përdorimit  
• Ndalim i menjëhershëm i depërtimit të ujit me presion në ndërtesa  
• Hidroizolim i ambjenteve nëntokësore me produkte hidroekspansive  
• Ndërhyrje strukturore mirëmbajtjeje për diga, vaska, ujësjellësa dhe kanalizime hidrike  
• Ndërhyrje strukturore mirëmbajtjeje të tuneleve dhe galerive  
• Realizimi i veprave nëntokësore në beton me papërshkueshmëri të lartë

Përbërësit  
Monokomponent

Paraqitja  
Guarnicion

## Përshkrimi i produktit

RINGSEAL T21 është një guarnicion me unazë të realizuar me një gomë special hidroekspansive që në kontakt me ujin kundërvepron duke rritur vëllimin e vet fillestar. RINGSEAL T21, e përdorur në kombinim me një diferencues tubash për rrjeta metalike, izolon hermetikisht ndërprerjet kalimtare që mund të futen lehtësisht në beton për shkak të pranisë së diferencuesit, dhe që mund të dëmtonin papërshkueshmërinë e vetë muraturës.

## Të dhëna shtesë

Në variantin stantart të guarnicionit RINGSEAL T21 është konceptuar për diferencues tubacionesh me diametër të brendshëm prej 21,5 mm (pa nervatura të jashtme), të përdorura normalisht në ndërtim dhe zakonisht me një diametër të jashtëm rreth 24 mm. Duke pasur parasysh elasticitetin e guarnicionit, mund të lejohen diametra më të mëdhenj deri në rreth 30 mm.

## Konsumi

N° 1 RINGSEAL T21 copë litari për secilën spacer tubo formë (mesatarisht 1 - 2 copë për metër katror për kallëpe metalike).

## Fushat e përdorimit

Realizimin e ndërtimeve nëntokësore prej betoni nëpërmjet rrjetave metalike, ku muri është në kontakt të drejtëpërdrejtë me tokën dhe ku nuk ka prani të shtresave të hidroizolimit të jashtëm nga muratura: bodrume, garazhe nëntokësore, ambjente përdhese, etj.


## Vetitë kryesore


 Diametri:  
21 mm

 I pandezshëm

 I përputhshëm në kontakt me ujin

 Jetëgjatësia:  
24 muaj

 Produkt hidroekspansiv:  
+200 / +900 %

 Rezistent ndaj rrezeve UV

 Ngjyrat në dispozicion  
Blu

## Shtresat e lejuara

Beton, Shpërndarës i kasetave të tubave prej PVC

IF YOU WANT TO SOLVE IT  
 azichem

[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: 25/08/2020  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet ligjore mund të lexohen në [www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)

## Mënyra e përdorimit

Vendoseni manualisht guarnicionin hidroekspanziv RINGSEAL T21 përçark diferencuesit të kallëpeve, në pozicion qëndror. Ndërtoni rrjetën e parashikuar duke përdorur diferencues të tubave të përgatitur në këtë mënyrë dhe vazhdoni me veprimet e zakonshme të hedhjes së betonit.

## Magazinimi e Ruajtja

Ruajeni produktin në ambalazhimin origjinal, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarën dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Mbrojeni nga lagështia.



## Rezultatet e provave të zgjerimit

RINGSEAL T21 ajo është testuar me katër lloje të ndryshme të tretësirave ujore:

- ujë të demineralizuar
- uji i "shtresës" (i marrë me kufi të përqendrimit nga D.Lgs 152/06: Ph 7.7, sulfate 250 mg / l, nitrat 50 mg / l, kloride 200 mg / l, hekuri 0,2 mg / l, mangan 0,05 mg / l, nikeli 0,2 mg / l)
- uji i kripur (3.6% NaCl)
- tretësirë bazë Ph 12.0 (për të simuluar kushtet në kontakt me beton)

Në provat eksperimentale të zhytjes në tretësirat e përshkruara, produkti ka shfaqur një ndryshim të vëllimit mesatarisht në 25 ditë jo më pak se 190% në rastin e ujit të kripur, duke arritur një zgjerim teorik prej më shumë se 1000% për ujin e demineralizuar. Ndryshimi i volumit llogaritet si  $(V_f \cdot V_i) / V_i$  (kështu që zgjerimi i 200% është ekuivalent me një vëllim të trefishtë në fund krahasuar me fillimin).

## Performanca

Unaza e guarnicionit hidroekspanziv RINGSEAL T21 zakonisht paraqet një rezistencë të mire ndaj acideve, alkaleve dhe tretësirave ujore. Në vijim një listë të shkurtër, si më poshtë:



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: **25/08/2020**  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
[www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)

|                  | <b>PËRBËRJA</b>            | <b>REZISTENCA</b> |
|------------------|----------------------------|-------------------|
| Tretësira ujore  | 15% Klorur natriumi        | Shumë e mirë      |
|                  | Larës për pjata            | Shumë e mirë      |
|                  | Pluhur biologjik për larje | Shumë e mirë      |
|                  | Ujë me klor                | Shumë e mirë      |
| Acide dhe alkale | 98% Acid Sulfurik          | E moderuar/e mirë |
|                  | 15% Acid Sulfurik          | Shumë e mirë      |
|                  | 10% Acid Kloridrik         | I moderuar/I mirë |
|                  | 50% Hidroksid Natriumi     | Shumë e mirë      |
|                  | 10% Hidroksid Potasi       | Shumë e mirë      |
|                  | 10% Sulfat Natriumi        | Shumë e mirë      |
| Tretës           | 10% Karbonat Natriumi      | Shumë e mirë      |
|                  | Cikloheksan                | Jo e përshtatshme |
|                  | Flatat dioklit             | Shumë e mirë      |
|                  | 95% Etanol                 | Shumë e mirë      |
|                  | Glicerinë                  | E mirë            |
|                  | Heksan / Pentan            | Jo e përshtatshme |
| Naftë / vajra    | Toluen                     | Jo e përshtatshme |
|                  | White Spirit               | E moderuar        |
|                  | /                          | Jo e përshtatshme |
| Yndyrë           | /                          | E moderuar        |
| Antingrirës      | 50% në ujë                 | Shumë e mirë      |

## Paralajmërimi, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjeguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: [www.azichem.com](http://www.azichem.com). Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: [www.azichem.com](http://www.azichem.com).

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose amballazhit të tij në mjedis.

Mos e përdorni RINGSEAL T21 me diferencues diametri i jashtëm i të cilit është më pak se 23.5 mm.

Gjithashtu nuk është e mundur të përdoren diferencues që kanë nervatura te jashtme në reliev, të cilat duke pasur një formë të jashtme jo rrethore, nuk do të lejonin depërtimin e përbërësit izolues në sipërfaqen e jashtme të diferencuesit, duke ndikuar në efektivitetin e tij.

Në rastin e zgjerimit me variacion shumë të theksuar volumesh (> 500%), dhe në mungesë të kushteve shtrënguese, mund të ndodhin plasaritje sipërfaqësore të guarnicionit; këto fenomene nuk komprometojnë fare funksionalitetin e pajisjes hermetike dhe mbi të gjitha nuk ndodhin në kushte normale të funksionimit, dmth. kur guarnicioni futet në vëllime të kufizuara.



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: **25/08/2020**  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet ligjore mund të lexohen në [www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali  
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: **25/08/2020**  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
[www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)